



QENDRESA  
QYTETARE

FRIEDRICH  
EBERT  
STIFTUNG

# ZGJEDHJET NË UNIVERSITETET PUBLIKE

RAPORT MONITORIMI  
— 21 QERSHOR 2024 —





## 1. Hyrje

## 2. Gjetjet kryesore

## 3. Procesi zgjedhor

- 3.1 Regjistrimi i kandidatëve
- 3.2 Kontrolli Anti - Plagjiaturë
- 3.3 Fushata zgjedhore dhe Transparenca e Procesit

## 4. Dita e Zgjedhjeve

- 4.1 Administrata dhe Infrastruktura zgjedhore
- 4.2 Procesi i votimit dhe mbyllja e tij
- 4.3 Procesi i numërimit

## 5. Rekomandime

**Shtojca 1.** Fisha e vëzhgimit të procesit zgjedhor dhe foto nga terreni

### **Punuan materialin:**

Kolindo Vjerdha dhe Rigels Xhemollari

### **Kontribuan si vëzhgues:**

Adelina Cikallesi, Anxhela Nelaj, Armela Kallari, Artea Hajdini, Dajana Xhemalaj, Elejda Isaraj, Elira Sylbashani, Eridona Kamberi, Esmeralda Sherifi, Fabjol Ziso, Hygerta Rapushi, Ines Deçolli, Marina Brega, Martina Gllavaj, Mikaela Gabeta, Ornela Neziri, Rea Xhukellari, Samanta Afesllari, Sonja Uruçi, Vesa Muka, Migen Qiraxhi, Dragana Kurti



# 1. Hyrje

Zgjedhjet në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë u mbajtën në datë 21 Qershor 2024 bazuar në Urdhrin nr.114, dt. 13.03.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ku përvec datës së zgjedhjeve, MAS urdhëronte IAL-të publike që të nisin procesin e tyre zgjedhor në datën 21/05/2024 dhe të miratojnë rregulloret e tyre të zgjedhjeve 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve.<sup>1</sup>

Sipas ligjit 80/2015 të drejtën për të zgjedhur autoritetet drejtuese (Rektor, Dekan, Përgjegjës Departamenti, Senat Akademik) e kishin: personeli akademik me 90% të peshës së votës dhe studentët me 10% të peshës së votës. Ndërsa të drejtën për të zgjedhur Anëtarët e Senatit Akademik, përfaqësues të studentëve e kanë vetëm studentët.

Qëndresa Qytetare monitoroi procesin e nxjerrjes së akteve nënligjore, administrimin e zgjedhjeve dhe verifikimin e plagjiaturave të kandidatëve për autoritetet drejtuese në universitete. Në monitorim më të thelluar dhe ndjekje me vëzhgues në terren janë marrë dy universitetet publike më të mëdha në vend: **Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës**, ndërsa fenomene dhe problematika të caktuara përgjatë procesit janë evidentuar edhe në 10 universitetet e tjera publike, të cilat do të jenë pjesë e gjetjeve dhe rekomandimeve të këtij raporti.

Qëndresa Qytetare iu drejtua me kërkesë për akreditim të vëzhguesve dy universiteteve të marra në monitorim.

**Universiteti Politeknik i Tiranës** aprovoi kërkesën e organizatës duke akredituar vëzhguesit e Qëndresës Qytetare të cilët u vendosën në qendrat e votimit të 7 Fakulteteve të UPT-së. Vëzhgimi i procesit përfshiu fazën e votimit, atë të numërimit dhe shpalljen e rezultateve zgjedhore. Vërtetimi i marrë në Komisionin Institucional Zgjedhor ishte i vlefshëm për të gjitha fakultetet dhe për të gjitha proceset zgjedhore të zhvilluara brenda këtij universiteti.

<sup>1</sup><https://top-channel.tv/2024/04/26/zgjedhjet-ne-universitete-ministria-e-arsimit-percakton-daten-21-qershor-studentet-paragjykes-per-rezultatit/>

Rektor i Universitetit u zgjodh Z. Akli Fundo me 95% të votave pro dhe 5% kundër.

**Universiteti i Tiranës** aprovoi kërkesën e organizatës duke akredituar vëzhguesit e Qëndresës Qytetare të cilët u vendosën në qendrat e votimi të 5 Fakulteteve të UT-së. Vëzhgimi i procesit përfshiu fazën e votimit, atë të numërimit dhe shpalljen e rezultateve zgjedhore. Komisioni Institucional Zgjedhor, u ndau vëzhguesve të Qëndresës Qytetare vërtetimin e vëzhguesit të vlefshme për të aksesuar vetëm procesin zgjedhor të zgjedhjes së studentëve, jo atë të pedagogëve duke kufizuar aksesin e vëzhguesve në procesin e votimit dhe të numërimit të votave të pedagogëve për organet drejtuese.

Gjithashtu vërtetimet e vëzhguesit ishin të vlefshme vetëm për qendra votimi të posacme, duke e kufizuar monitorimin si të pjesshëm dhe jo të plotë për këta vëzhgues.

Rektor i Universitetit u zgjodh Z. Artan Hoxha me 89.22 % të votave pro.<sup>2</sup>

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti monitorues do t'i përcillen institucioneve publike të arsimit të lartë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Këshillave Studentore.

*Ky raport u realizua nga Qëndresa Qytetare me mbështetjen financiare të Fondacionit gjerman Friedrich Ebert. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.*

---

<sup>2</sup> <https://unitir.edu.al/vendim-kiz-nr-67-date-22-06-2024-per-shpalljen-e-rezultatit-te-zgjedhjeve-per-pozicionin-e-rektorit-ne-universitetin-e-triranes/>

## 2. Gjetjet kryesore

- 10 nga 12 e universiteteve publike nuk i kërkuan kandidatëve për postet drejtuese dokumentacion provues për kriteret e ndjekjes penale, bazuar në rregulloret e tyre të zgjedhjeve.
- Në zbatim të VKM nr. 777 për kontrollin Anti - Plagjiaturë, 11 universitete publike e realizuan këtë proces nëpërmjet vetëdeklarimit të mungesës së plagjiaturës në punimet shkencore. Vetëm UBT ushtroi kontrollin Anti - Plagjiaturë për kandidatët.



- Në 7 nga 12 universitete publike dhe 50% të Fakulteteve të UT dhe UPT, gara për drejtues u zhvillua me një kandidat të vetëm, duke eliminuar alternativat dhe përballjet e ideve. Fituesit grumbulluan 90 – 95% të votave të pedagogëve.



- Procesi zgjedhor në UT u shoqërua me mungesë transparence duke moslejuar prezencën e medias në Qendrat e Votimit dhe prezencën e vëzhguesve të akredituar të organizatave në procesin e numërimit në Universitetin e Tiranës.



- Dita e zgjedhjeve u karakterizua nga fenomene të ngjashme me zgjedhjet politike si orientimi i studentëve nga pedagogët për të votuar për kandidatë të caktuar, prezenca e personave të paautorizuar në QV-të dhe intimidimi i votuesve, kryesisht studentët. U evidentuan vëzhgues të kandidatëve të cilët bënë propagandë në qendrat e votimit.



- 
- Procesi i votimit u zhvillua përgjithësisht i qetë, por me problematika të infrastrukturës zgjedhore, duke evidentuar dhoma votimi me logo partie, fletë votimi me njiyra të padaullueshme, mungesë ngjyre për timbrimin e gishtit, fotografim të votës dhe përodrim të celularëve në qendrat e votimit.

- 
- 11 universitete, publikuan rezultatin e zgjedhjeve brenda 48 orëve nga mbarimi i procesit të votimit, me përjashtim të universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër, ku vendim i komisioni zgjedhor u mor 6 ditë pas mbarimit të votimit, duke krijuar tensione dhe debate mes kandidatëve dhe anëtarëve të KIZ.




Universiteti i Shkodrës shpalli fituesin  
6 ditë pas mbarimit të votimit

### 3. Proçesi zgjedhor

Në 13 Mars 2024, Ministria e Arsimit dhe Sportit Ogerta Manastirliu urdhëroi fillimin e procesit zgjedhor për drejtuesit e universiteteve në datën 21.05.2025, duke caktuar si datë zgjedhesh 21 Qershorin 2024.

Nëpërmjet këtij Urdhri MAS urdhëroi nxjerrjen e rregulloreve të zgjedhjeve nga IAL-të publike, 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Universitetet ruajtën përgjithësisht të njëjtat rregullore të miratuara në vitin 2020. Ky urdhër me caktimin e datës 21 qershor, si datë zgjedhesh, rrezikon të ndërpresë mandatet e të zgjedhurve aktualë, pa mbushur afatin 4- vjecar të tyre, prandaj në pikën 4 të tij thuhet se Minsitria e Arsimit do t'i përcjellë rezultatet zgjedhore tek Presidenti për dekretimin e të zgjedhurve të rinj, pasi të ketë përfunduar afati 4 vjecar i drejtuesve aktualë, pra pas muajit gusht 2024.



Për shkak të dinamikave të zhvilluara gjatë këtij procesi zgjedhor, Qëndresa Qytetare e ka monitoruar procesin zgjedhor të klasifikuar në disa faza:

- **Regjistrimi i kandidatëve për organet dhe postet drejtuese**
- **Kontrolli Anti – plagjiaturë**
- **Fushata Zgjedhore dhe transparenca e procesit**

### 3.1 Regjistrimi i kandidatëve për organet dhe postet drejtuese

Kandidatët për rektor dhe për senat akademik të institucioneve të arsimit të lartë publik në vend duhet të plotësonin disa kriteret të paracaktuara mbi të cilat do të bazohej pranimi ose jo i kërkesës për aplikimin si kandidat. Referuar Rregullores për Organizimin e Zgjedhjeve në universitete një ndër kriteret bazë, përcaktuese për kandidaturën si në nivel rektori dhe senati akademik është **kriteri i ndjekjes penale të kandidatëve.**

Në monitorimin e kryer të të gjitha rregullores të institucioneve të arsimit të lartë në vend rezulton se shumica prej tyre e kanë të përcaktuar këtë kriter në nenet e lidhura me kriteret e kandidimit të rektorëve dhe kandidatëve për anëtar në senatin akademik. Këtu bën përjashtim Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu”, i cili si kriter nuk saksionon “ndjekjen penale” të kandidatit për rektor, por vetëm një vërtetim për caktim mase sigurie.

Megjithëse e kanë këtë kriter të sanksionuar në nenet e rregullores, **10 nga 12 institucionet e arsimit të lartë nuk kanë të përkthyer këtë masë në dokumentacionin e kërkuar të kandidatit.** Këtu bëjnë përjashtim Universiteti i Gjirokastrës “Eqerem Çabej” dhe Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, që në dokumentacionin e kërkuar e kanë të përcaktuar se një prej dokumentave duhet të jetë “vërtetim nga prokuroria se kandidati nuk ndodhet në ndjekje penale”.

Gjykojmë se një boshllëk i tillë mes kriterëve të kërkuara dhe dokumentacionit të detyrueshëm për kandidim mund të ketë krijuar hapësira që në keto universitete **të kandidojnë kandidatë që janë aktualisht në ndjekje penale ose me masë sigurie.**

**Fenomeni i “kandidatëve të vetëm”** mbizotëroi universitetet kryesore të vendit (të cilat kanë mbi 80-90% të studentëve total në vend) duke minimizuar garën, alternativat dhe debatin konstruktiv mbi perspektivat dhe sfidat e universiteteve publike.

**Shtatë universitete publike** shkuan në zgjedhjet për Rektor **me një kandidat të vetëm.** Pesë nga 6 universitetet që zhvillojnë veprimtarinë



e tyre në kryeqytet, kishin një kandidatë të vetëm për Rektor. Ndërkohë Komisioni Zgjedhor i Universitetit “Aleksandër Xhuvani” eliminoi nga gara kandidaten Majlinda Perriu, me justifikim se nuk ia lejonte ligji për Prefektin, post të cilin kandidatja e kishte dorëzuar 2 ditë përpara se të vendoste për të kandiduar në këtë post. Ky proces tashmë ndodhet në Komisionin e Apelit të Universitetit.

## Zgjedhjet për Rektor

Universitetet	Nr.Kandidateve	Fakultetet	Nr.Kandidateve
U. I Tiranës	1 	F. i Shkencave të Natyrës	2
U. Politeknik I Tiranës	1 	F. i Gjuhëve të Huaja	1 
U. I Sporteve	1 	F. i Histori Filologjisë	2
U. i Mjekësisë Tiranë	1 	F. i Ekonomisë	1 
U. Bujqësor I Tiranës	1 	F. i Drejtësisë	1 
U. I Arteve	2 	F. i Shkencave Sociale	2
U. “Luigj Gurakuqi” Shkodër	3 		
U. “Fan Noli” Korçë	3 	F. i Inxhinierisë së Ndërtimit	2
U. “Eqerem Cabej” Gjirokastrë	1 	F. i Gjeologjisë dhe të Minierave	3
U. “Aleksandër Moisiu” Durrës	4 	F. i Inxhinierisë Elektrike	2
U. “Ismail Qemali” Vlorë	4 	F. i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	1 
U. “Aleksandër Xhuvani” Elbasan	1 	F. i Inxhinierisë Mekanike	2
		F. i Teknologjisë dhe Informacionit	1 
		F. i Arkitekturës dhe Urbanistikës	1 
		Instituti I Gjeoshkencave	1

 Një kadidateje l është refuzuar kandidimi

Ndërkohë të njëjtin trend kanë ndjekur në dy universitetet më të mëdha të vendit edhe kandidatët për drejtues të njëjësive kryesore (Fakulteteve), ku **50% e kandidatëve për Dekan në Universitetin e Tiranës dhe në Universitetin Politeknik të Tiranës garonin të vetëm**, pra pa kundërshtar përballë, të reflektuara në tabelën e mësipërme.

Një problematikë tjetër e evidentuar përgjatë procesit të regjistrimit të kandidatëve ishin edhe **vonesat e konstitutimit të komisioneve zgjedhore dhe më pas regjistrimit të kandidatëve**, nga afatet e përcaktuara në Urdhrin e Ministrisë së Arsimit, duke mos lejuar një fushatë të plotë 30 ditore zgjedhore, përpara trupës zgjedhore të përbërë nga studentë dhe pedagogë të universiteteve publike. Universitetet që u vonuan më shumë në këtë proces ishin UPT dhe universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër duke shpallur listën e kandidatëve për postet drejtuese në datën **27 maj 2024, ndërkohë që në datën 21 qershor zhvilloheshin zgjedhjet, ndërsa Universiteti i Arteve ishte universiteti që i shpalli i pari numrin e kandidatëve, përkatësisht në datën 30 prill.**<sup>3</sup>

### 3.2 Kontrolli anti - plagjiaturë

Ndryshe nga Urdhri i Ministres Besa Shahini për zgjedhjet e vitit 2020, ku specifikoheshin në institucionet e arsimit të lartë publik duhej që çdo kandidat të nënshtrohej kontrollit anti-plagjiaturë dhe verifikimit të titujve shkencorë dhe rezultatet të ishin pjesë e dosjes së tij të kandidimit, në Urdhrin e ministres Ogerta Manastirliu **ky obligim nuk qëndronte**, duke iu shmangur edhe VKM-së 777.<sup>4</sup> Por Universitetet Publike, tashmë duke e pasur të integruar procesin e kontrollit antiplagjiaturë në rregulloret e tyre, nuk mund t'a shmangnin plotësisht këtë proces nga dokumentacioni garues, duke e lënë sipas procedurës së vetëdeklarimit. Në datën 7 qershor, studiuesi Taulant

Muka publikoi dhe dërgoi në Universitetin e Tiranës denoncimin për plagjiaturë në punimet doktrale të kandidatit për Rektor në Universitetin e Tiranës Artan Hoxha dhe kandidates për Dekane në Fakultetin e Drejtësisë në këtë universitet Dorina Hoxha duke sfiduar Komisionin Institucional Zgjedhor dhe Këshillin e Etikës të këtij

**FORMULAR VETËDEKLARIMI**  
NË ZBATIM TË RREGULLORES  
“PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET  
DREJTUESE DHE SENATIN AKADEMIK NË UNIVERSITETIN  
ALEKSANDËR MOISIU”

Në mbështetje të Nenit 18/19/20/21 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin Aleksandër Moisiu”, unë....., kandidat për postin....., deklaroj nën përgjegjësinë time për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e Gradës/Titullit shkencor.

Emër Mbiemër

<sup>3</sup> [https://upt.edu.al/permbajtja/uploads/2024/05/VENDIM-NR-4-KIZ-SHPALLJA-E-AFATEVE-TE-REGJISTRIMIT-TE-KANDIDATEVE-PER-REKTOR-SENAT-AKADERMIK\\_compressed.pdf](https://upt.edu.al/permbajtja/uploads/2024/05/VENDIM-NR-4-KIZ-SHPALLJA-E-AFATEVE-TE-REGJISTRIMIT-TE-KANDIDATEVE-PER-REKTOR-SENAT-AKADERMIK_compressed.pdf)

<sup>4</sup> <https://fdut.edu.al/wp-content/uploads/2021/09/Vendimi-I-KM-Nr.-777-dat%C3%AB-26122018-perditesuar.pdf>

universiteti për të gjykuar mbi këto fakte të reja mbi kandidatët në fjalë.<sup>5</sup>

Pavarësisht denoncimit, presionit të shtuar mediatik, pranimit të "gabimit" të kandidatit Hoxha për BIRN Albania dhe komunikimeve formale apo informale me drejtues të instancave brenda (Komisioni Institucionale Zgjedhore dhe Keshilli Etikes se UT) dhe jashtë UT si Presidenti i Republikës dhe Komisioni Parlamentar i Arsimit **nuk pati asnjë nismë për të trajtuar denoncinimin** e studiuesit Muka përpara zhvillimit të zgjedhjeve në 21 qershor 2024.<sup>6</sup>

### 3.3 Fushata zgjedhore dhe Transparenca e Procesit

Fushata për zgjedhjet e 21 Qershorit ishte e heshtur **pa debate** apo përballje publike, jo vetëm për shkak se në 58% të posteve garonin kandidatë të vetëm, të cilët nuk kishin nevojë për t'u angazhuar maksimalisht për të fituar garën por edhe për shkak të një tradite jo të mirë të konsoliduar nga vitet e shkuara ku kandidatët për zgjedhjet në universitete nuk kanë pasur përballje direkte.

Kandidati për Rektor në Universitetin e Tiranës **aktivizoi pas 4 viteve profilin e tij në rrjetet sociale në momentin e shpalljes si kandidat, profil i cili ishte lënë në heshtje nga shpërndarja e posterave elektorale të zgjedhjeve të 4 viteve të kaluara**, sipas konstatimeve të vëzhguesve të Qëndresës Qytetare, ndërsa kandidati për Rektor në Universitetin Politeknik të Tiranës **nuk kishte një profil në këto rrjete dhe nuk pati asnjë komunikim në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale të këtij universiteti.**<sup>7</sup> Të dy kandidatet për Rektor për universitetet më të mëdha të vendit nuk patën asnjë komunikim për mediat e shkruara apo vizive për kandidimin apo vizionin e tyre, komunikime të cilat në zgjedhjet e 2020 kanë qenë më të shpeshta.

Nga monitorimi i faqes zyrtare të Universitetit të Tiranës, rezulton se rrjetet sociale të këtij universiteti dhe web-i zyrtar **janë vënë në**

<sup>5</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=C5MuBvj1S4E>

<sup>6</sup> <https://www.gazetatema.net/sociale/rektori-artan-hoxha-une-te-bej-plagjiature-maksimumi-ndonje-gabim-kam-be-i443563>

<sup>7</sup> <https://www.facebook.com/Prof.Dr.Artan.Hoxha>

**dispozicion të fushatës së kandidatit për Rektor** Artan Hoxha, pasi kanë shpërndarë aktivitete zgjedhore të këtij kandidati.<sup>8</sup>

Shqetësues nga raportimet, denoncimet dhe vëzhgimet e Qëndresës mbetet rreziku i përdorimit të aseteve, burimeve dhe kompetencave për qëllime të fitores së kandidatëve në rastet kur kërkojnë konfirmim në detyrë apo në këmbim të kandidatit që mbështesin. Rastet më shqetësuese edhe nga raportimet janë shpërndarja e titujve Profesor 1 dite para çeljes së garës në Universitetin e Tiranës, rinovimi i kontratave të punës, përpara zgjedhjeve nga Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, **duke krijuar praktikën e përdorimit të burimeve publike, për qëllime zgjedhore**, e cila për referim të Kodit Zgjedhor, duhet të reflektohet si ndryshim në rregulloret e zgjedhjeve të universiteteve, duke ndaluar që në periudhat zgjedhore të ndalohen punësimet, rinovimet, titujt dhe honoraret.

Ndërkohë **kandidatët për Anëtar të Senatit Akademik nga studentët patën një fushatë më aktive**, realizuan një përballje publike me studentët dhe përdorën rrjetet sociale për të shpalosur platformat e tyre. Nga 11 kandidatë – studentë që garuan në Universitetin e Tiranës, për Anëtar Senati, 4 prej tyre u zgjodhën, ndërsa në Universitetin Politeknik të Tiranës aplikuan 9 kandidatë, një u skualifikua për mosplotësim të kriterit të mesatares, dhe në përfundim u zgjodhën 4 nga 8 kandidatë garues.<sup>9</sup>

Rezultatet e zgjedhjeve për pozicionet, Rektor dhe Anëtarë të Senatit Akademik u shpallën në 11 universitete brenda një fashe kohore që nuk kalon më shumë se 24 orë nga përfundimi i procesit të votimeve, rezultate të shpallura me vendim të Komisioneve Istitucionale Zgjedhore. Vonesë në shpallje ka pasur vetëm në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Nga monitorimi i kryer rezultoi se edhe pas 48 orëve nga mbyllja zyrtare e procesit zgjedhor, afat pas të cilit duhet të shpallehin rezultatet, **në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", nuk ka patur**

<sup>8</sup> <https://unitir.edu.al/te-vijojme-te-forcojme-universitetin-e-tiranes/>

<sup>9</sup> <https://upt.edu.al/permbajtja/uploads/2024/05/Vendimi-06-date-27.05.20242.pdf>

**vendimmarrje për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, duke tejkaluar këtë afat. Vendimi për shpalljen e rezultateve u mor 6 ditë pas përfundimit të procesit zgjedhor, për shkak të përplasjeve mes anëtarëve të komisionit zgjedhor të cilët përfaqësonin rryma të kundërta mbi interpretimin e rregullores së zgjedhjeve.**

**Gazetarët dhe përfaqësues të mediave u penguan** të hynin në dy universitetet e monitoruara nga Qëndresa Qytetare për të pasqyruar procesin zgjedhor. Komisioni Institucional Zgjedhor i UPT vendosi të lejojë prezencën e medias pas gjysmës së dytë të ditës në hapësirat e qendrave të votimit.<sup>10</sup>

Në datën 7 qershor 2024 Qëndresa Qytetare dërgoi një kërkesë për informacion pranë Komisionit Institucional Zgjedhor të UT për të marrë formularin e vetëdeklarimit të mungesës së plagjiaturës të kandidatëve për Rektor dhe Dekan të Fakultetit të Drejtësisë. Ditën e



dhjetë zyrtare pas dërgimit të kësaj kërkesë, KIZ i ktheu përgjigje Qëndresës Qytetare duke **refuzuar këtë informacion me justifikimin se dhënia e këtij informacioni nuk ishte pjesë e kopetencave të këtij organi.**

<sup>10</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=SCEezfYzsvc>



## 4. Dita e Zgjedhjeve

Qëndresa Qytetare vëzhgoi procesin ditën e zhvillimit të zgjedhjeve, 21 Qershor 2024 në Universitetin e Tiranës dhe Universitetin Politeknik të Tiranës duke vendosur 24 vëzhgues të përzgjedhur nëpërmjet një thirrje të hapur të cilët kaluan në një proces trajnimi mbi zgjedhjet dhe etikën e vëzhguesit nga ekspertë të botës akademike, por dhe proceseve zgjedhore. Një grup pune me ekperiencë në vëzhgimin e zgjedhjeve i ngritur nga Qëndresa Qytetare gjithashtu përgatiti fishat e raportimit të cilat i shërbyen çdo vëzhguesi për t'i plotësuar e më pas raportuar. Vëzhguesit u akredituan nga Universitetet dhe u vendosën në qendrat e votimit të 5 Fakulteteve të UT dhe 7 Fakulteteve të UPT.

Vëzhgimi i procesit përfshiu fazën e votimit, atë të numërimit dhe shpalljen e rezultateve zgjedhore.

Rektor i Universitetit Politeknik të Tiranës u zgjodh **Z. Akli Fundo me 95% të votave pro dhe 5% kundër**, ndërsa Rektor i Universitetit të Tiranës u zgjodh **Z. Artan Hoxha me 89.22 %** të votave pro. Problematike në Universitetin e Tiranës në këtë rezultat ishte fakti i mungesës së numrit total të pjesëmarrësve, numrin e votave kundër dhe numrin e votave të pavlefshme, duke krijuar paqartësi dhe mungesë transparence.

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga 24 vëzhguesit e Qëndresës Qytetare të cilët gjatë ditës së votimit kanë pasur mundësi të monitorojnë 31 qendra votimi përgjatë ditës së zgjedhjeve sipas fishave të raportimit u konstatua:

### **Nisja e Procesit të Votimit**

Nga Qendrat e Votimit të monitoruara, 70% e tyre u raportuan me nisje të procesit të votimit në orën e parashikuar 8:00, vonesa më e gjatë u regjistrua në qendrën e votimit për pedagogët të Fakultetit të Histori – Filologjisë, ku procesi i votimit nisi në **8:46**.

### **Listat e zgjedhësve**

80% e fakulteteve kanë publikuar listat e zgjedhësve në ambientet e fakultetit të tyre. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike ka vendosur vetëm online listat, ndërsa Fakulteti i Inxhinierisë së Matematikës dhe Inxhinierisë Fizike në Universitetin Politeknik të Tiranës nuk janë konstatuar listat e zgjedhësve.

### **KQV-të dhe Anëtarët Studente**

Në të gjitha qendrat e votimeve është konstatuar se sipas rregullit një prej anëtarëve është student.

### **Etika e Vëzhguesit në KQV**

Vetëm në 30% të KQV raportohet se vëzhguesit përfaqësues të kandidatëve në garë kanë respektuar etikën dhe nuk kanë bërë proagandë për kandidatin, fenomen ky i vërejtur më së shumti nga vëzhguesit e akredituar nga kandidatët studentë për antar senati.

### **Fleta e votimit**

Nga të gjithë vëzhguesit u Konstatua se fleta e votimit përmban të gjitha elementët e parashikuar në nenin 31 të rregullores.

### **Dhoma e Votimit**

Nga të gjithë vëzhguesit e instaluar në qendrat e votimit u konstatua se dhoma e votimit siguron fshehtësinë e votës dhe intimitetin e votuesit.

### **Udhëzuesit**

Nga të gjithë vëzhguesit u konstatua se në ambientet e votimit ishin të publikuara udhëzimet për procedurat e kryerjes së votimit, si edhe anëtarët e komisionit shpjegonin në të gjitha rastet, pyetjet apo pasiguritë e votuesve.

### **Kutitë e votimit**

Nga të gjithë vëzhguesit u konstatua se kutitë e votimit ishin transparente dhe të përshtatshme për procesin e votimit.

### **Celular gjatë votimit**

Në pjesën më të madhe të qendrave të votimit vëzhguesit konstatuan përdorimin e aparateve celulare nga vëzhguesit, por edhe pjesëmarrësit në votim, pavarësisht se sipas rregullores kjo ishte e ndaluar.



### Verifikimi votuesve

Procesi në përgjithësi ka shkuar pa problematika, por gjithsesi janë konstatuar raste të studentëve që nuk e gjetën emrin në listë duke u larguar pa votuar dhe raste të paraqitjes së ID nëpërmjet fotografisë me telefon.

### Votim jashtë dhomës së votimit

Nga të gjithë vëzhguesit u konstatua se nuk ka pasur asnjë rast të plotësimit të fletës së votimit jashtë dhomës së votimit.

### Mbyllja e procesit

Në përfundim të procesit në të gjitha QV-të kryetari i KZF shënoi numrin e zgjedhësve që votuan në proceverbal.

Në përfundim të procesit në të gjitha QV-të e vëzhguara kryetari i KZF deklaroi me zë të lartë shifrat e pjesëmarrjes në votim përpara vëzhguesve.

Në përfundim të procesit në të gjitha QV-të e vëzhguara, vëzhguesit shoqëruan kutitë në vendet e numërimit.

Qendresa Qytetare konstatoi se në Fakultetet e UT dhe UPT, ku gara zhvillohej me më shumë se një kandidat si tek Fakulteti i Histori Filologjisë apo Fakulteti i Shkencave të Sociale pjesëmarrja e studentëve në zgjedhje ishte më e lartë, vëzhguesit ngriten shqetësimin se mund të jetë përdorur mekanizmi **që kandidatët për dekanë të kenë caktuar data provimesh ditën e zgjedhjeve** dhe për të orientuar studentët nga pedagogu për të votuar në grup pas mbarimit të provimit.



Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës u raportua një incident jo i zakonshëm ku **persona të paautorizuar dhe pa lidhje me procesin zgjedhor, ushtruan presion ndaj pedagogëve**, anëtarë të komisioneve zgjedhore. Pas njoftimit të policisë situata u neutralizua.

Në qendrat e votimit dhe pranë tyre u evidentuan nga vëzhguesit **postera të kandidatëve për Senat AkademiK nga studentët të ekspozuar gjatë procesit zgjedhor**, postera të cilët duhet të ishin larguar nga autoritetet që kujdesen për zgjedhjet prej ditës së heshtjes zgjedhore një ditë para votimit. Qëndrimi i tyre mund të konsiderohet shkelje e barazisë në garë dhe mund të ndikojë në orientimin e votës ditën e zgjedhjeve.

## 4.1 Administrata dhe infrastruktura zgjedhore

**Administrata zgjedhore në Institucionet e Arsimit të Lartë përbëhet nga tre nivele:**

**Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ):** KIZ përbën organin më të lartë për administrimin e zgjedhjeve në një universitet. Ky komision përbëhet në çdo rast nga të paktën pesë anëtarë (përbërja është gjithmonë numër tek) të zgjedhur me votë të fshehtë nga Senati AkademiK. Ndër të tjera, KIZ ka për detyrë organizimin e procesit zgjedhor në universitet, regjistrimin e kandidatëve dhe shpalljen e rezultateve për Rektor dhe Senat AkademiK, krijimin e KZF-ve, etj. Kandidatët për Rektor kanë të drejtën e një përfaqësuesi pranë KIZ, si një ex-officio, pa të drejtë vote.

**Komisioni i Zgjedhjeve në Fakultete (KZF):** KZF përbën organin më të lartë të administrimit zgjedhor në njësinë kryesore. Ajo përbëhet nga një numër tek anëtarësh dhe në çdo rast jo më i vogël se tre anëtarë, ku njëri është përfaqësues nga studentët. Kandidatët për KZF vetkandidohen. Ndër të tjera, KZF regjistron kandidatët dhe shpall rezultatet për Dekan dhe drejtues të njësive bazë, emëron KQV-të, publikon listat e zgjedhësve, shërben si KQV kur njësia kryesore ka vetëm një QV, numëron votat, etj. Kandidatët për Dekan dhe

përgjegjës të njërive bazë kanë të drejtën të kenë një përfaqësues të akredituar pranë KZF-së.

**Komisioni i Qendrës së Votimit (KQV):** Krijohet nga KZF për çdo QV kur në njësinë kryesore ka më shumë se një QV. Përbëhet nga një numër tek anëtarësh të vetkandiduar, në çdo rast jo më pak se tre anëtarë, ku njëri është përfaqësues nga studentët. Kandidatët për KQV vetëkandidohen. KZF ka për detyrë përgatitjen e QV-së dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor gjatë ditës së zgjedhjeve.

Administrata zgjedhore **përgjithësisht ka respektuar rregulloren** duke marrë masat e nevojshme për realizimin e një procesi zgjedhor të rregullt duke afishuar listat e votuesve, duke siguruar fshetësinë e votës dhe duke publikuar udhëzimet mbi procesin e votimit.

Por pavarësisht masave të marra **rreth 20% e qendrave të votimit** u hapën 30 deri në 60 minuta me vonesë nga orari i caktuar në rregullore. Vonesat në qendrat e tjera erdhën për shkak të vonesës në procesin përgatitor nga administrata zgjedhore dhe mungesës së bazës materiale.

## 4.2 Procesi i votimit dhe mbyllja e tij

Votimi në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe Universitetin e Tiranës u krye konform Rregullores dhe pa probleme. Në përgjithësi komisionet e QV-ve qenë vazhdimisht korrekte, duke bërë të mundur që votuesit të votonin sipas rregullave dhe të drejtave. Të gjithë zgjedhësit përpara momentit të votimit treguan ID ose pasaportën përpara komisionit. Administrata zgjedhore u bëri thirrje vëzhguesve të pavarur për të mos përdorur aparate celulare në ambientet e votimit, por nga ana tjetër u vu re se disa votues nga momenti që futeshin në sallë dhe derisa mbaronin procedurën e votimit mbanin dhe përdornin aparatet celular me vetë në mënyrë të dukshme.

Nga ana tjetër, nuk munguan rastet e propagandës pranë qendrave të votimit dhe ushtrimit të presionit kundrejt votuesve ku vëzhgues të kandidatëve për Rektor ose Dekanë bënë propagandë dhe ndikonin votues të studentëve për të marrë pjesë në zgjedhje.

Gjithashtu u evidentua prania e studentëve të pautorizuar ose kandidatëve për Anëtar Senati nga studentët, të cilët **shoqëronin dhe drejtonin studentët në qendrat e votimit duke orientuar për**



**votimin e kandidatëve të caktuar** kryesisht kandidatët për senatin për studentët, dukuri kjo e shtrirë gjërë në UT dhe më problematike në Fakultetin e Ekonomisë dhe Shkencave të Natyrës.

Printimi i fletëve të votimit me ngjyra vetëm në njërën anë të fletës pamundësonte që votuesi të identifikonte ngjyrën e 5 fletëve të votimit se cilës kuti i përkiste, duke u detyruar **në shumë raste hapjen e tyre për verifikim pranë kutisë duke cënuar privatësinë e votës.**



**Nga vëzhguesit e Qëndresës Qytetare u identifikuan raste të fotografimit të votës si dhe përdorim të aparateve celulare në qendrën e votimit nr. 5 pranë FEUT.**

Në universitetin “Ismail Qemali” në Vlorë u identifikuan dhoma votimi të mbishkruara me logon e Partisë Socialiste.

### 4.3 Procesi i numërimit

Mbyllja e QV-ve në të gjitha fakultetet e vëzhguara u krye me rregull dhe qetësi të plotë, meqenëse edhe fluksi i votuesve pothuajse kishte reshtur. Me përjashtim të disa QV-ve në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Natyrës, të cilat u mbyllën në 16:30, të gjitha QV-të e tjera u mbyllën në kohë.

Pavarësisht vështirësive më sipër, çdo procedurë e vendim i komisioneve u krye në transparencë të plotë, në praninë e vëzhguesve.

Procesi i numërimit vijoi i qetë dhe pa probleme. Numërimi u krye në mënyrë transparente në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe me problematika të aksesit të vëzhguesve në Universitetin e Tiranës.

Mosrespektimi i të gjithë hapave nuk cënoi procesin e numërimit dhe rezultatet e zgjedhjeve. Numërimi i votave për studentët u diferencua nga numërimi i votave për pedagogët, duke krijuar konfuzion për vëzhguesit.

11 universitete publike, publikuan rezultatin e zgjedhjeve brenda 48 orëve nga mbarimi i procesit të votimit, me përjashtim të **universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër, ku vendim i komisioni zgjedhor u mor 6 ditë pas mbarimit të votimit, duke krijuar tensione dhe debate mes kandidatëve dhe anëtarëve të KIZ.**

Tabelat përfundimtare të votave u ndanë me vëzhguesit dhe përfaqësuesit e ministrisë së Arsimit.

## Rekomandime

- **Komisionet Institucionale Zgjedhore duhet të vërtetojnë statusin penal të kandidatëve për organet drejtuese në universitete duke kërkuar dokumente provuese nga organet e hetimit penal, si vërtetim për masë sigurie dhe ndjekje penale.**

---

- **Parlamenti i Republikës së Shqipërisë duhet të rishikojë ligjin 80/2015 me fokus rritjen e peshës së votës studentore.**

---

- **Menaxhimi i zgjedhjeve në universitete sugjerohet t'i kalojë si kopetencë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve bazuar në praktikat më të mira, me qëllim mbarëvajtjen e një procesi të paanshëm, të lirë dhe të ndershëm sipas parimeve të OHDIR.**

---

- **Proceset zgjedhore duhet të jenë më transparente dhe të hapura për publikun, duke lejuar aksesin e medias dhe vëzhguesve nga shoqëria civile, pa u kufizuar në Qendra të posacme Votimi, apo vetëm në pjesë të ndara të procesit.**

---

- **Këshillat e Etikës duhet të fillojnë menjëherë zbatimin e VKM nr.777 për kontrollin anti-plagjiaturë të drejtuesve të zgjedhur në 21 Qershor 2024. Komisionet Zgjedhore dhe ato të Apelimit duhet të trajtojnë menjëherë ankesat e dërguara për plagjiaturë, mospërputhje dokumentacioni apo refuzim kandidimi nga KIZ-et.**

---

- **Kandidatët për postet drejtuese nga pedagogët apo studentët duhet të qëndrojnë më larg qendrave të votimit, intimidimit dhe orientimit për votën dhe më pranë përballjes së ideve, projekteve transformuese dhe përballjes me trupën zgjedhore.**

---

- **Komisionerët duhet të informohen më mirë mbi të drejtat dhe detyrimet e vëzhguesve për të evituar abuzimet edhe nga ana e tyre brenda QV-ve. Nevojitet një përpjekje më e madhe për të edukuar votuesit mbi subjektet që ata po votojnë dhe platformat e tyre.**

---

- Rregulloret për Zgjedhjet në universitete duhet të rishikohen për të përcaktuar qartë procedurat për vlefshmërinë e votave të hedhura në kutitë e gabuara ashtu dhe procedurat për numërimin e këtyre votave.

## Shtojca 1. Fisha e vëzhgimit të procesit zgjedhor

NR	Procesi i votimit (sheno me X)	PO	JO	Koment
	<b>A) INFRASTRUKTURA DHE DOKUMENTACIONI PËR ZGJEDHJET</b>			
1	Qendra e Votimit u hap në 8:00 .			
2	Ne mjediset e Fakultetit jane publikuar listat e zgjedhesve.			
3	Nje prej 3 anetareve te KQV është student.			
4	A është e vendosur selia e KZF në godinën ku zhvillohet aktiviteti mësimor ose kërkimor njësia kryesore ?			
5	Dhoma e votimit siguron fshehtesine e votes dhe intimitetin e votuesit.			
6	Ne ambientet e votimit janë te publikuara udhezimet per procedure e kryerjes se votimit.			
7	1 Ore para nisjes se procesit te votimit, KZF u tregoi veshguesve kutite bosh.			
8	Kutite e votimit ishin transparente.			
9	Ne ambientet e votimit veshguesit nuk bejne propogande per kandidatet.			
10	Fleta e votimit permban te gjitha elementet e parashikuar ne nenin 31 te rregullores.			
11	Fletët e votimit për studentët a e ka të shkruar në sfondin e saj cilësimin "Për Studentët"?			
	<b>B) PROCEDURA E VOTIMIT</b>			
12	Votuesit nuk kishin celular ose aparat me vete gjate kryerjes se procedures se votimit.			
13	Zgjedhesit tregojne ID ose Pasaportën para Komisionit te Votimit.			
14	Gjatë verifikimit të emrit të votuesve përpara se të pajisen me fletët e votimit, a kanë pasur probleme me të dhënat e cdo votues (student/staf akademik)			
15	Gjatë procesit të votimit u ruajt distanca 2 metër ndërmjet personave të pranishëm.			
16	A u votua jashtë dhomës së votimit?			
17	Nëse u votua jashtë dhomës së votimit, a u lejuan që këto fletë votimi të hidhen në kutitë përkatëse?			
	<b>B) MBYLLJA E VOTIMIT</b>			

18	Mbyllja e votimit u realizua ne oren 16:00?			
19	A u votua pas orës 16:00? Nëse po, si u procedua			
20	Nëse u votua pas orës 16:00, sa është numri i votuesve?			
21	Kryetari i KZF shënoi numrin e zgjedhësve që kanë votuar në proceverbale.			
22	Sa ishte numri i votuesve në përfundim të votimit?			
23	Kryetari i KZF deklaroi me zë të lartë shifrat e pjesëmarrjes në votim përpara vëzhguesve.			
24	A u realizua mbyllja e kutive sipas rregullores, duke u shoqeruar me elementet e sigurise?			
25	Vëzhguesit shoqëruan kutitë në vendet e numërimit.			
	<b>C) PROCESI I NUMERIMIT</b>			
26	Kryetari i KZF/KIZ hap kutitë e votimit sipas rradhës dhe bën vlerësimin e votave duke i vendosur ato një për një mbi tavolinë.			
27	Votat e pavlefshme u ndanë në grupe të vecanta ose ftoi vëzhguesit të verifikojnë fletët e dëmtuara.			
28	Kryetari i KIZ numëroi ose ftoi vëzhguesit të verifikojnë fletët bosh.			
29	A u zhvillua numërimi i votave sipas rradhës së kutive (neni 37) - Rektor - Dekan - Shef Departamenti - Anëtar i Senatit Akademik - Anëtar i komisionit të përhershëm			
30	A u bë transparentë tabela e votave për cdo kandidat?			
31	A u bë transparente tabela e votave përfundimtare dhe u nda jo me vëzhguesit dhe përfaqësuesit e ministrisë?			
32	Procesi i numerimit ishte transparent për vëzhguesit dhe publikun.			



Ekipi i monitoruesve, pranë UPT para nisjes së monitorimit!







QENDRESA  
QYTETARE

FRIEDRICH  
EBERT  
STIFTUNG

— [www.qq.com.al](http://www.qq.com.al) —